



Fëmijët e vegjël, lojërat dhe mësimi i hershëm

TË MËSOJMË SË BASHKU – FËMIJËT E VEGJËL, LOJËRAT DHE MËSIMI I HERSHËM

Fëmijët e vegjël janë njerëz shumë të zënë. Ata janë të zellshëm të mësojnë për botën përreth dhe të mahnitën nga gjëra që juve ju duken të thjeshta. Një pjesë të mëngjesit ata mund ta kalojnë duke vrapuar nëpër park – bëhen më të mirë në fillimin e vrapimit, në të ndalur, në të ecur para dhe prapa, si dhe në kthimin e shpejtë djathtas. Pastaj një kohë të gjatë mund të qëndrojnë qetë, të luajnë me guralecë dhe me degë.

Nëse është gjithçka në rregull, fëmijët e vegjël ndryshojnë plotësisht në vitin e dytë të jetës së tyre. Ata po ashtu mund të lëvizin të pavarur, mund të flasin me fjalët e tyre dhe të kuptojnë më shumë nga ajo që e thoni ju.

Lodrat e mira për mësim

Fëmijët e vegjël kënaqen duke luajtur me materiale të ndryshme. Ata kanë nevojë për shumë sende për lojë, por nuk është e thënë që të gjitha lodrat të jenë të blera. Para se t'i shpenzoni paratë tuaja për lodër, shikojeni me kujdes atë. A mund ta përdorin fëmijët e vegjël atë në mënyra të ndryshme? A do ta përmbushin atë me të cilën kënaqen? Shumë lodra të shitores reklamohen si të mira për "mësimin e hershëm". Por, fëmijët mësojnë edhe përmes përvetësimit të përvojave të ndryshme, e jo vetëm duke luajtur me disa lodra plastike. Nëse lodra është me interes të kufizuar, fëmijët e vegjël shpejt do ta braktisin duke u dhënë pas kulisë më interesante në të cilën ka ardhur lodra e re. Shpenzoni paratë për materiale loje që nuk mund t'i krijoni ose t'i kompiloni. Ja disa ide të mira për lodra që mund t'i blini ose t'i kompiloni nga ajo që tashmë e keni:

- Me një qerre solide të dorës mund luajnë një periudhë më të gjatë. Kjo u krijon baraspeshë fëmijëve të vegjël, të cilët ende luhaten derisa ecin. Por, shumë shpejt ajo qerre do të jetë e mirë për bartjen e koteleve ose të koneve të fëmijës së vogël.
- Fëmijët e vegjël kanë nevojë për më shumë katrorë të drurit ose të plastikës. Së pari ata duan të ndërtojnë kulla të thjeshta ose ta rrënojnë atë që e keni bërë ju. Fëmijët e vegjël e zhvillojnë të kuptuarit për hapësirën dhe format duke i vendosur dhe duke i nxjerrë nga kutia katrorët e duke e përsëritur këtë nga disa herë. Më vonë, në fëmijërinë hershme, ata dhe shokët e tyre do të ndërtojnë gjithçka që e ndez fantazinë e tyre – garazhe për qerret, kafaz për dinozaurët e tyre etj.
- Fëmijët e vegjël kanë dëshirë të madhe të mbledhin, të kategorizojnë dhe t'i ndajnë në lloje të veçanta gjërat. Ju mund të blini një lodër të thjeshtë për kategorizim, por diturinë e njëjtë mund ta përvetësojnë edhe me kuti të ndryshme e me madhësi të ndryshme, si dhe me "arkë postare" të krijuar në shtëpi.

- Kutitë e mëdha të kartonit janë po ashtu të dobishme, sepse fëmija në to mund të ulet, mund të shtyhen si në qerre dhe ato mund të stolisen. Ato shumë shpejt do të shndërrohen në autobus për t'u ulur, në shpellë për t'u fshehur dhe në tavolinë të imagjinuar.
- Fëmijët e vegjël kanë dëshirë të madhe të vishen dhe të duken bukur, por për këtë kanë nevojë për veshje të blera enkas për këtë. Ata dëshirojnë të mbajnë kapela, çanta dhe veshje që mund të vishen lehtë, siç janë shallet e bukura ose jelekët për kostume. Ashtu siç zhvillohet fantazia e tyre, materiali i bukur mund të shndërrohet në pelerinë, në fund ose në veshje si flutur.
- Në një çantë ose shportë të madhe mblidhni materiale të sigurta, që përdoren në amvisëri, të cilat në të kundërtën do të ricikloheshin ose do të hidheshin në shportën e mbeburinave. Shkencëtarët e vegjël argëtohen derisa i hulumtojnë gypat e kartonit, shishet e plastikës me grykë të gjerë, grykën e çezmës ose të çikrikut, konservat (të pastra dhe të zbrazëta), ambalazhet nga supermarketi dhe kapëset e vjetra të drurit që përdoren për tharjen e veshjeve. Shihni a është gjithçka e sigurt që të mund ta fusin edhe në gojë, sepse fëmijët e vegjël disa gjëra i fusin edhe në gojë. Shmanguni nga kutitë me polistirol poroz dhe, kuptohet, gjithçka që është më skaje të mprehta.

Fëmijët mësojnë kur kanë kohë dhe hapësirë për të ushtruar. Ata do t'i përsërisin aktivitetet, shpesh me ndryshime të vogla. Në këtë mënyrë ata mund ta kuptojnë se si funksionojnë gjërat. Kështu binden se cila do jetë pasoja e ndonjë aktiviteti dhe a do ta mbledhë diçka diku apo jo. Përpiquni të shihni përtej rrëmujës që bie në sy në shikim të parë, që ashtu të shihni se çka janë duke gjurmuar dhe çka kanë mësuar fëmijët e vegjël. Kuptohet, është e arsyeshme të parashtroni disa rregulla themelore si "ngjyrat dhe plastelina do të mbeten në tavolinë, mbi mushama". Lehtësojuni fëmijëve të vegjël që të mund të bëhen pjesë e ngritjes së gjërave në vendin e tyre dhe jepuni kohë t'i gjejnë sendet, t'i pastrojnë dhe t'i vendosin në kuti ose në shporta.

Të mësuarit nga jeta e përditshme

Fëmijët e vegjël nuk mësojnë vetëm nga ajo që të rriturit e konsiderojnë lojë. Ata mësojnë më shumë kur do të dilni të shëtiteni te fqinjët. Foshnjat dhe fëmijët e vegjël janë shumë të interesuar për unazën rrugore, që është pranë shtëpisë suaj. Shëtitja nëpër lagje ose ecja nëpër treg u mundëson atyre mjaft kohë që ata të ndalen dhe të shikojnë duke u habitur. Fëmijët e vegjël do të thonë dhe do të shpjegojnë se ai kënd është i njohur për ata, ndërsa nuk do të harrojnë ta përmendin vinçin që sapo është vendosur në sheshin e ndërtimit. Dituria e fëmijëve të vegjël mbindërtohet edhe përmes përvojave të thjeshta, siç janë: dërgimi i letrave, blerja e bukës dhe vëzhgimi i një brumbulli të zi që ecë nëpër trotuar.

Si ia fillojnë të lëvizin, fëmijët e vegjël kanë dëshirë t'ju ndihmojnë juve në gjërat e përditshme. Jepuni mjaft kohë në mënyrë që ata të ndjehen se janë të dobishëm.

- Do ta vëreni se si përqendrohen derisa e përdorin fshesën dhe lopatën ose derisa e ujsin kopshtin.
- Kur të ndihmojnë në ngritjen e gjërave, fëmijët e vegjël e kuptojnë se kafshët duhet të futen në fermë, ndërsa sharra duhet vihen në raftin e saj.
- Kur jeni në shitore, lëreni fëmijën që vetë ta gjejë qumështin dhe të zgjedhë disa pemë e perime. Ata ndjejnë kënaqësi se janë të inkuadruar dhe ashtu mësojnë shumë fjalë.
- Fëmijët e vegjël janë të përgatitur për gatim të thjeshtë, si dhe për të ndihmuar në gjërat e përditshme, siç është vendosja e tavolinës. Ata fillojnë ta kuptojnë numërimin e thjeshtë në situata siç janë: "Kemi nevojë edhe për një lugë" ose "Shtoji edhe dy filxhanë..." (bëni me shenjë me gishta që kjo të jetë shenjë vizuale).

Fëmijët e vegjël kanë nevojë për një periudhë më të gjatë kohore që të mund të kujdesen plotësisht për veten e tyre. Ata nuk mund të ushtrojnë që vetë të ushqehen ose të veshin xhemper – nëse keni ardhur në sprovë që t’jua lejoni të përpiqen, që ashtu të kurseni kohë dhe që ata të mos shkapërderdhin. Më e shpejta nuk është gjithnjë më e mira. Sapo t’i kuptojnë më mirë mundësitë, fëmijët e vegjël mund të mësojnë një kohë më të gjatë. Përveç shkathtësive fizike, ata mësojnë edhe për shkakun dhe pasojën: çka është ajo që vijon pas diçkaje tjetër, si dhe për planifikimin e thjeshtë me kohë.

Lodra nga materialet natyrore

- Fëmijëve të vegjël u pëlqen prekja e ujit dhe ata përdorin sende të ndryshme që të derdhen, të mbushin dhe të zbrazin ujë. Mbusheni me ujë lavamanin në shtëpi, madje, nëse ka nevojë, vendosni shkallë që ai të mund të ngjitet. Rëra ose gjërat e tjera të thata, siç janë orizi dhe brumërat, mund të futen në legenin për larje ose enët e tjera të plastikës.
- Fëmijët e vegjël janë të përgatitur për art të thjeshtë aplikativ. Duart dhe gishtat janë aletet më të mira për të vizatuar. Ata shumë shpejt do të mund të punojnë me brusha të mëdha, copëza sfungjeri, ngjyra të yndyrshme dhe shkumësa të mëdhenj. Lërimi ta shtrijnë letrën dhe gjeni mënyrë që atë ta bëjnë jashtë kur është moti i nxehtë. Lërimi të kënaqen në atë që e bëjnë dhe mos i shpejtoni të vizatojnë ndonjë gjë të caktuar.
- Fëmijët e vegjël kënaqen kur luajnë me plastelinë, sepse atë mund ta formësojnë si të duan: ta shtypin, ta mbështjellin dhe t’i japin çfarëdo forme tjetër. Prandaj është mirë të blini një çikrik plastelinë. Format për prerjen e brumit mund të jenë në raftin tuaj ose në pjesën e pajisjeve të kuzhinës në supermarket.

Fuqia e të menduarit te fëmijët

Shkrim-leximi i hershëm është shumë i rëndësishëm. Ndërsa mënyra më e mirë për inkurajimin e tij është të krijohet kënaqësi në libra bashkë me fëmijët e tjerë. Mbajeni mend momentin kur do të fillojnë të kenë libra që do t’i duan dhe ato lexoni nga disa herë. Fëmijët e vegjël kënaqen në pauzat dramatike, si dhe përsëritjen e frazave që ata mund t’i shqiptojnë. Disa fëmijë të vegjël vetë ia fillojnë ta shpjegojnë përrallën dhe dëshmojnë se e kuptojnë se si funksionojnë librat – duke i shfletuar faqet në mënyrë të drejtë ose duke thënë “Fund” kur të përfundojë përralla. Ju shfaqni mahnitje kur ata do të mund ta lidhin atë që e shohin jashtë me fotografinë e librit – fara e madhe e lulediellit ose makina e zjarrfikësve.

Këngët e fëmijëve u ndihmojnë atyre që t’i kuptojnë skemat tingullore në mënyrë që më vonë do t’u ndihmojë atyre gjatë leximit dhe shkrimit. Ato po ashtu u ndihmojnë fëmijëve t’i mësojnë detajet e shumë tingujve që e përbëjnë gjuhën.

Ndërmjet ditëlindjes së tyre të parë dhe të dytë, fëmijët e vegjël mësojnë mjaft që ta dinë se si funksionon bota dhe që të fillojnë të mendojnë për gjëra, si dhe që të luajnë lojën e “shtirjes”. Lojërat e para të shtirjes rëndom janë të shkurtra – fëmija i vogël mund të shtirret se është duke ngrënë duke përdorë lugë. Shumë shpejt ata do të shtiren se e vënë arushën e vogël në gjumë ose se janë duke udhëtuar me makinë nëpër “rrugë”. Fëmijët e vegjël fillojnë të tregojnë mahi, bëhen sikur ena në dorën e tyre është kapele ose dikujt me qëllim i drejtohen me emër të gabuar. Buzëqeshja e tyre tregon gjithçka: “Ti e di se unë e di se ti që gjithçka është shtirje”.

Shumë gjëra ndodhin në kokën e fëmijës së vogël. Por, të rriturit mund të kenë vështirë ta kuptojnë mënyrën e tyre të të menduarit. Ekziston një sprovë që fëmijët të shpejtojnë me idetë e tyre, siç janë ngjyrat dhe format. Këto ide neve na duken të qarta, por nuk ka ndonjë arsye se pse

do të duhej vepruar sikur ngjyrat dhe format të jenë më të rëndësishme se ato ide që fëmijët e vegjël fillojnë t'i kuptojnë. Fëmijët e vegjël para së gjithash mësojnë fjalë që i shënjojnë emrat e njerëzve dhe sendeve të njohura. Pastaj ata mësojnë fjalë që paraqesin aktivitete. Vetëm atëherë ata fillojnë të përdorin fjalë që e përshkruajnë botën e tyre, ndërsa kanë të bëjnë me idetë e tyre. Ky zhvillim rëndom ndodhë në gjysmën e dytë të vitit të jetës. Dëgjoni fëmijët më të rritur dhe mund të dëgjoni: "e madhe", "e lartë", "e shijshme", "e nxehtë", "e gërditshme" dhe fjalë të tjera për këto ide. Këto fjalë nuk kanë kuptim derisa fëmijët e vegjël nuk përvetësojnë një fond më të madh të fjalëve për emërtimin e aktiviteteve, sepse fjalët duhet të ndërlidhin diçka. "E madhe" dhe "e lartë" janë fjalë ideore që nuk mund të qëndrojnë vetë. Nuk mund ta keni vetëm fjalën "i madh" – autobusi është i madh.

Ju mund t'u ndihmoni fëmijëve të vegjël që ta bëjnë hapin më të madh ndaj disa ideve kur të dëgjoni dhe shikoni se çka ka pasur kuptim deri tash. Nuk duhet të shpejtoni që t'i detyroni të mësojnë. Në vend të kësaj, futni fjalët në bisedë kur do të ketë mundësi përkatëse për këtë. Për shembull: "A dëshiron t'i veshësh sot pantallonat e kaltra?" ose "Uh sa ke bërë titur duke teshtirë!" Shënoni këto dhe shfaqni mahnitje nga të gjitha fjalët që përfshijnë ide. Ngjyrat dhe format do të vijin me kohë.